



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 15 prill 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Teuta Hadri dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj-administratore, Drita Morina-zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri-zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta-nëpunëse administrative;

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri,
Nga-NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
4. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

Armend Zemaj - Pati vërejtjen se shërbimi për informim i Kuvendit nuk i përcjell mbledhjet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me plotësimin e dhënë nga deputetja Nurishahe Hulaj.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetari - Pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se Komisioni në mbledhjen e kaluar i ka shqyrtuar disa nga amendamentet e propozuara nga grupi punës për Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në mbledhjen e kaluar Komisioni i ka dëgjuar palët e interesuara lidhur me nenin 12 të këtij Projektligji. Ai ishte i mendimit që ky nen të mbetet si në Projektligjin e propozuar nga Qeveria, ose në vend të çdo i 25-ti punëtor të jetë çdo i 40-ti punëtor, person me aftësi të kufizuara.

Nurishahe Hulaj - Tha se këtu duhet të merret parasysh një kriter. Për shembull, standardi në rajon - sa është përqindja e personave me aftësi të kufizuara në njëqindmijë banorë.

Flora Brovina - Ishte e mendimit që neni 12 të mbetet si në Projektligj. Përfaqësuesit që i mbrojnë interesat e punëdhënësve nuk arritën ta bindin Komisionin se pse “neni 12” duhet të ndryshojë dhe pse fjala “obligim” duhet të hiqet nga ky nen. Ajo gjithashtu tha se nuk është e pajtimit që si model për këtë çështje të merret Ligji i Shqipërisë, por për model të merren ligjet nga shtetet, si: Kroacia, Sllovenia etj., në mënyrë që ky Ligj të jetë më i avancuar.

Qamile Morina - Tha se i ka konsultuar ligjet në rajon se si është rregulluar kjo çështje. Tha se në Slloveni ekziston kuota sipas së cilës minimumi i personave me aftësi të kufizuara, të punësuar është 2 %, ndërsa maksimumi është 6%. Në rast se kjo kuotë bie nën 2%, atëherë është një mekanizëm që fillon të punojë, që kuota, përkatësisht ta arrijë minimumi. Sllovenia i ka të sistematizuar njerëzit me aftësi të kufizuara që mund të shkojnë në punë normale. Këtë duhet ta vlerësojë komisioni i ekspertizës. Lidhur me nenin 12 ishte e mendimit që Komisioni ose duhet ta përkrahë propozimin e Kryetarit, që ky numër të jetë 40, ose kjo çështje të përcaktohet me kuotë, ndërsa obligimi për punëdhënësit që parashihet me nenin 12 për tregun e punës, paraqet problem.

Armend Zemaj - Tha se edhe para se të dëgjohen palët ka kërkuar që të shikohet çështja që çdo i 25-ti punëtor të jetë person me aftësi të kufizuar i punësuar. Me këtë Ligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, do të fillojë rregullimi i kësaj kategorie, i beneficioneve dhe i kushteve, ndërsa e tërë konkurrenca do të bëhet në tregun e hapur.

Gjylnaze Sylja - Konsideron se investimet në Kosovë më tepër kanë të bëjnë me sundimin e Ligjit se sa me përcaktimin e numrit të personave me aftësi të kufizuara siç definohet në projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Edhe pse e morëm një propozim nga NDI se si është e rregulluar kjo çështje në Shqipëri, megjithatë ajo është e interesuar se si është e rregulluar kjo çështje me ligjet e Bashkimit Evropian. Pra sipas saj Komisioni është dashur t'i ketë disa modele të shteteve evropiane lidhur më këtë çështje.

Mimoza Ahmetaj - Ishte e mendimit që kjo çështje të mbetet si në Projektligj.

Shefki Kastrati - Asistent i NDI-së tha se modeli që ai ka ofruar nuk është qëndrimi NDI-së. Ai këtë e ka bërë personalisht si asistent i NDI-së me qëllim që ta ndihmojë Komisionin. Ndoshta është dashur që Komisionit t'ia ofrojë dy ose tri modele. Ai tha se sipas rregullave standarde për barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuara nuk ka kuotë të përcaktuara. Kuota është e rregulluar varësisht nga shtetet.

Komisioni pas diskutimeve vendosi që neni 12 të mbetet si është propozuar në Projektligj.

Amendamentet që u pranuan në parim, për të cilat nuk pati diskutime janë: 24, 25, 26, 27, 28, 30, 31, 39, 40.

Amendamentet për të cilat pati diskutime në mbledhjen e Komisionit janë: 21, 22, 29, 32, 33, 34, 35, 36, 37.

Komisioni nuk i miratoi amendamentet e propozuara 21 dhe 22.

Amendamenti 23

Në nenin 13, paragrafi 4, në rreshtin e dytë, të hiqen fjalët “*merren vesh*” dhe të zëvendësohen me fjalën “*kontaktojnë*”.

Gjylnaze Syla - Lidhur me amendamentin 23 propozoi që në vend të fjalëve “*merren vesh*” të jetë fjala “*informoi*”.

Nurishahe Hulaj - Propozoi që në vend të fjalëve “*merren vesh*” të jetë fjala “*kontraktoi*”.

Komisioni për amendamentin 23 vendosi të mbetet si në Projektligj, vetëm të hiqet fjala “*mund*” në rreshtin e dytë.

Komisioni nuk e miratoi amendamentin 29

Qamile Morina – E propozoi një amendament në nenin 19 me këtë përmbajtje: në nenin 19, paragrafi 1, pika 4, pas fjalës “*të tjera*” të shtohet teksti “*shërbimet komunale, mjetet kreditore*”.

Mimoza Ahmetaj - Ishte kundër propozimit të deputetes Qamile Morina, me arsyetimin se në nenin 21 përmenden të gjitha shërbimet, duke i përfshirë edhe ato komunale.

Komisioni nuk e miratoi propozimin e deputetes Qamile Morina.

Amendamenti 32

Në nenin 19, pas paragrafit 2, të shtohet një paragraf i ri 3, me këtë përmbajtje:

“Procedura për realizimin e këtyre përfitimeve rregullohet me akt nënligjor nga ministria kompetente dhe në përputhje me dispozitat ligjore tatimore dhe doganore në fuqi”.

Gjylnaze Syla - Propozoi që fjalët “*Ministria kompetente*” të zëvendësohen me fjalët “*Ministria përkatëse*”.

Komisioni e miratoi amendamentin 32 me plotësimin e propozuar nga deputetja Gjylnaze Syla.

Amendamenti 33

Në nenin 23, paragrafi 2, riformulohet: “*destinimin e donacionit në formë të grantit e përcakton donatori në marrëveshje me kritere të caktuara nga ana e Ministrisë dhe donatorit*”.

Rita Hajzeraj - Tha se kjo çështje është e rregulluar shumë mirë me Ligj. Propozoi që amendamenti 33 të mos miratohet.

Komisioni u pajtua me propozimin e deputetes Rita Hajzeraj për heqjen e amendamentit të propozuar 33.

Komisioni vendosi të hiqen edhe amendamentet 34 , 35 , 36 , 37, sepse janë të ndërlidhura me amendamentin 33.

Amendamenti 38

Neni 27, paragrafi 2, riformulohet: “*nënkodin buxhetor për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin për personat me aftësi të kufizuara e themelon Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Kosovës*”.

Armend Zemaj - Tha se nënkodet buxhetore i përcakton vetëm Qeveria, jo Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Gjylnaze Sylja - Propozoi një riformulim për nenin 27, paragrafi 2: “*nënkodin buxhetor për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin për personat me aftësi të kufizuara, e menaxhon dhe e mbikëqyr Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Kosovës*”. Ajo tha se Këshilli Drejtues është organ që del nga Ministria, andaj ky Këshill nuk mund të menaxhojë me të holla. Nënkodin buxhetor, sipas saj, e menaxhon dhe e mbikëqyr Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ajo e parashtroi pyetjen se a ekziston sistemi informativ financiar.

Kryetari - Tha se me zgjidhjen që e kemi dhënë, me këtë amendament, e kemi anuluar Këshillin Drejtues, të emëruar nga Qeveria.

Komisioni e miratoi amendamentin 38 me riformulimin që e bëri deputetja Gjylnaze Sylja.

Amendamenti 40

Në nenin 28, paragrafi 1, riformulohet: “*Me gjobë në të holla prej 500 deri në 2000 euro do të dënohen për kundërvajtje punëdhënësi dhe personi përgjegjës i tij*” dhe vazhdon teksti si në Projektligj.

Armend Zemaj - Tha se gjoba nuk e përcakton veprën penale. Propozoi që me një pikë të përcaktohet destinimi i mjeteve të grumbulluara nga gjobat.

Gjylnaze Sylja - Tha se nuk mjafton vetëm dispozita ndëshkimore, por duhet të shtohet edhe një nen i veçantë, se kundër vendimit administrativ punëdhënësi mund të bëjë ankesë.

Qamile Morina - Propozoi një riformulim për nenin 29: “*Mbikëqyrja profesionale kryhet nga komisioni profesional që e emëron ministri i MPMS. Mbikëqyrjen financiare e bën Këshilli Drejtues që e emëron Qeveria. Mbikëqyrjen e realizimit të së drejtës së punësimit, sipas këtij ligji e bën Inspektorati i Punës*”. Ajo tha se këtu duhet të përfshihet mbikëqyrja e gjithë sistemit, së pari e

vlërësimeve për aftësinë e punës së këtyre personave. Nëse Këshilli nuk e mbikëqyr, atëherë dikush duhet ta bëjë këtë mbikëqyrje. Inspeksioni i punës nuk është kompetent t'i mbikëqyrë financat.

Mimoza Ahmetaj - Ishte e mendimit që paragrafi 2 i amendamentit të propozuar nga deputetja Qamile Morina, të hiqet.

Armend Zemaj - Tha se mbikëqyrjen e ligjshmërisë së zbatimit të këtij Ligji dhe të akteve nënligjore e bën Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai ishte kundër propozimamendamentit të propozuar nga deputetja Qamile Morina.

Me këtë propozim u pajtua edhe deputetja Gjylnaze Syla.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash u miratua amendamenti i propozuar: “Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së zbatimit të këtij Ligji dhe të akteve nënligjore e bën Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”, ndërsa nuk u përkrah propozimi i deputetes Qamile Morina.

Qamile Morina - Ka propozuar një amendament lidhur me nenin 32, në rreshtin e fundit afati “1 vjet” të hiqet dhe të bëhet “jo më larg se 6 muaj”. Ajo tha se ky Ligj është propozuar në vitin 2007 dhe është ndarë buxheti për ndërtimin e qendrave, prandaj mendoj se për t'u shfrytëzuar ai buxhet këtë vit afati të jetë 6-mujor.

Komisioni nuk e miratoi propozimin e dhënë nga deputetja Qamile Morina.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit për të votuar për propozimamendamentet e paraqitura në dy mbledhjet e Komisionit lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kryetari konstatoi se unanimisht u miratuan amendamentet e propozuara.

Amendamenti 1

Në preambulë në vend të „ Kuvendi i Kosovës” të jetë „Kuvendi i Republikës së Kosovës”

Komisioni Funksional

Amendamenti 2

Në preambulë pjesa e parë riformulohet :

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të kreut 5.1 (j) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë,

Komisioni Funksion

Amendamenti 3

Titulli i Projektligjit riformulohet :

„Projektligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara”

Komisioni Funksional

Amendamenti 4

Në tërë tekstin e P/Ligjit fjala „ Rehabilitim’’ të zëvendësohet me fjalën „aftësim , riaftësim’’

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 5

Neni 2 riformulohet :

Qëllimi i këtij Projektligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 6

Në nenin 3 paragrafi 2 riformulohet :

„Personi me aftësi të kufizuar për punë, është personi me aftësi të kufizuar, aftësia e te cilit në raport me aftësitë e personit që nuk ka aftësi të kufizuar të moshës së njëjtë ose të përafërt, me edukim të njëjtë ose të përafërt , me kushte të njëjta të punës ose të përafërta, në punë të njëjtë, ose të përafërt ka si pasojë aftësinë e kufizuar të përhershme ose së paku 12 muaj, mundësinë e zvogëluar për aftësim, mundësinë e zvogëluar të punësohet dhe të punon në tregun e punës me kushte të përgjithshme dhe të barabarta’’.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 7

Në nenin 3 paragrafi 3 fshihet fjalia „, kategoritë e personave me aftësi të kufizuar , si pasojë e dëmtimit ’’ dhe zëvendësohet me fjalinë „, llojet e aftësisë së kufizuar “dhe vazhdon teksti si në P/Ligj.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 8

Në nenin 3 paragrafi 5 në rreshtin e parë fshihet fjalia „,element ’’ dhe zëvendësohet me fjalën „, proces ’’ dhe në rreshtin e dytë fshihet fjalia „, e shkathtësive ’’.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 9

Në nenin 3 paragrafi 6 në rreshtin e parë pas fjalës „, mjekësorë ’’ shtohet fjalia „, dhe lëmive të tjera ’’ dhe vazhdon teksti si në P/Ligj .

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 10

Në nenin 3 paragrafi 11 riformulohet :

„ Trajneri është personi profesionist i certifikuar i punës, i përgatitur dhe i ngarkuar për ofrimin e ndihmës së aftësimin dhe të riaftësimin profesional për personin me aftësi të kufizuar, në pajtim me kërkesat e vendeve të punës në tregun e hapur të punës”

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 11

Në nenin 3 paragrafi 12 riformulohet :

„ Aftësimi dhe riaftësimi profesional, nënkupton të gjitha aktivitetet që synojnë të sigurojnë njohuri, aftësim dhe përvojë të re për aftësim të nevojshëm, për punë efikase brenda profesionit , profesionit që e ka kryer edhe më parë, para aftësisë së kufizuar, ose riaftësimin për një profesion të ri që mund ta bëjë me sukses”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 12

Në nenin 3 pas paragrafit 14 shtohet paragrafi i ri 15 me përmbajtje:

„Asistenti është personi i domosdoshëm për personin e caktuar pa të cilin personi me aftësi të kufizuar nuk mund aftësohet apo të riaftësohet për punë ose të krijojë marrëdhënie pune” .

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 13

Në nenin 4 paragrafi 1 pika 1 riformulohet :

„ Personi me aftësi të kufizuar, shfrytëzues i mjeteve financiare, i cili realizon të drejta dhe përfitimet sipas dispozitave ligjore për ndihmë sociale dhe pensioneve të personave me aftësi të kufizuar”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 14

Në nenin 4 paragrafi 4 riformulohet :

„Nxënësi prej moshës 15-18, me aftësi të kufizuar mendore, fizike, psikike ose të kombinuara sipas dispozitave ligjore të aplikueshme për shkollimin e mesëm, duke i siguruar atij që ka nevojë edhe gjuhën e shenjave për personin e shurdhët dhe Alfabetin e Brajtit për të verbër.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 15

Në nenin 5 paragrafi 3 riformulohet :

„Ndalohet diskriminimi ndaj personit me aftësi të kufizuar mundësitë e të cilit për sigurimin,

ruajtjen ose përparimin në një pune te përshtatshme janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme.

Komisioni Funksional

Amendamenti 16

Në titullin e kapitullit III fshihet fjalia „CAKTIMIN E PAFTËSISË” dhe zëvendësohet me „VLERËSIMIN E AFTËSISË”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 17

Në nenin 6 paragrafi 1 bëhet 2 ndërsa paragrafi 2 bëhet 1 .

Komisioni Funksional

Amendamenti 18

Në nenin 6 paragrafi 3 riformulohet :

„ Iniciativa për fillimin e procedurës për njohjen e të drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni , paraqitet me kërkesën e personit me aftësi të kufizuara. Në pamundësi të iniciativës për fillimin e procedurës nga ana e personit me aftësi të kufizuar , iniciativën për procedurë e bën familja e tij e ngushtë, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi i tij ose personi i tretë .

Komisioni Funksional

Amendamenti 19

Në nenin 6 paragrafi 4 riformulohet :

Kërkesa për procedure për zvogëlimin e aftësisë se kufizuar për punë mundë të ngritët në bazë të kërkesës së vetë personit me aftësi të kufizuar, anëtarit të familjes së ngushtë, përfaqësuesit të tij ligjorë ose kujdestarit të tij.

Komisioni Funksional

Amendament 20

Në nenin 7 paragrafi 3 në rreshtin e tretë pas fjalës “të drejtës” të shtohet fjala “për punë” vazhdon teksti si në P/Ligj.

Komisioni Funksional

Amendament 21

Në nenin 8 paragrafi 1 në rreshtin e katër fjala “të peshës” të fshihet dhe të zëvendësohet me fjalën “të shkallës”

Komisioni Funksional

Amendamenti 22

Neni 10 paragrafi 1 pika 2 riformulohet :

„ Parimet, mënyra e veprimit dhe metodat e përgatitjes profesionale të zbatuara përgjithësisht në kualifikimet e personave të tjerë, zbatohet në rastet e personit me aftësi të kufizuar, deri në atë mase sa lejojnë mundësitë e tij.

Komisioni Funksional

Amendamenti 23

Në nenin 13 paragrafi 4 në rreshtin e dytë fshihet fjalia „ mund të ” .

Komisioni Funksional

Amendamenti 24

Titulli i nenit 14 riformulohet :

Qendra për **aftësim dhe riaftësim** profesional dhe punësim në Kosovës

Komisioni Funksional

Amendamenti 25

Në nenin 14 paragrafi 3 në rreshtin e parë fshihet fjalia „ rehabilitim profesional” dhe zëvendësohet me fjalinë „ aftësim dhe riaftësim profesional dhe punësim ” dhe vazhdon teksti si në P/Ligj.

Komisioni Funksional

Amendamenti 26

Në nenin 14 paragrafi 7 në fund të këtij paragrafi shtohet fjalia „ të nxjerrë nga MPMS “

Komisioni Funksional

Amendamenti 27

Në nenin 14 pas paragrafit 7 shtohet paragraf i ri 8 me përmbajtje :

„Qendrën për aftësimin dhe riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar e themelon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në afat prej një viti pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji ”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 28

Në nenin 18 paragrafi 3 riformulohet :

„Stimulimi nga paragrafi 1 i këtij neni, i kontraktuar me bartësin e sigurimit të punësimit është stimulim i njëhershëm material si: mjete për adaptimin e vendit të punës dhe kushteve të punës, mjete kreditore me kushte të volitshme të destinuara për blerjen e makinave, pajisjeve, mjete tjera ose veglave të punës që nevojiten për punësimin e personit me aftësi të kufizuar, dhe mjetet e kompensimit të diferencës për shkak të zvogëlimit të efektit të punës, orarit të punës si dhe bashkëfinancimin e pagesës së asistencës të personit me aftësi të kufizuar ”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 29

Në nenin 18 pas paragrafit 3 shtohet paragrafi i ri 4 me përmbajtje :

„Për personin me aftësi të kufizuar 100% të shfrytëzimit të pensionit të aftësisë së kufizuar , pensioni të shndërrohet në asistence personale për ndihmësin në punë (asistentin e tij)”.
Komisioni Funksional

Amendamenti 30

Në nenin 19 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3 me përmbajtje :

„ Procedura për realizimin e këtyre përfitimeve rregullohet me akt nënligjor nga Ministria përkatëse dhe në përputhje me dispozitat ligjore tatimore dhe doganore ne fuqi.
Komisioni Funksional

Amendamenti 31

Në nenin 27 paragrafi 2 riformulohet :

„ Nënkodin buxhetor për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin për personat me aftësi të kufizuar, e menaxhon dhe mbikëqyrë Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Kosovës”.
Komisioni Funksional

Amendamenti 32

Në nenin 27 paragrafi 3 riformulohet :

„ Të ardhurat janë mjetet nga buxheti i Kosovës si mjete të themeluesit , mjetet e kontributeve të veçanta, mjetet e pashpenzuara nga destinime të veçanta, të ardhurat e tjera në bazë të ligjit dhe dispozitave tjera, si dhe donacionet e personave juridik vendor dhe të jashtëm”.
Komisioni Funksional

Amendamenti 33

Në nenin 28 paragrafi 1 riformulohet :

„ Me gjobë në të holla prej 500 deri 2000 €do të dënohet për kundërvajtje punëdhënësi dhe personi përgjegjës i tij” dhe vazhdon teksti si në P/Ligj .
Komisioni Funksional

Amendamenti 34

Në nenin 29 fshihet fjalia „ Agjencion Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës “ dhe zëvendësohet me „ Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale”

Flora Brovina - Propozoi që Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ta organizojë një vizitë në Qendrën Rehabilituese në Ferizaj.

Ky propozim u miratua nga anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara

Kryetari – E ftoi raportuesen e këtij Projektligji, deputeten Flora Brovina, që ta bëjë prezantimin e propozimamendamenteve.

Flora Brovina bëri prezantimin e propozimamendamenteve

Amendamentet që u miratuan në parim, për të cilat Komisioni do të votojë në fund të shqyrtimit, janë: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 12, 14, 15, 17.

Amendamentet, për të cilat në Komision pati diskutime, janë : 4, 11, 13 dhe 16.

Amendamenti 4

Në nenin 2, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “mendore” hiqet “apo” dhe në rreshtin e tretë pas fjalës moshës “1” bëhet “0”.

Rita Hajzeraj - Tha se aftësitë e kufizuara të fëmijës, nuk mund të identifikohen nga mosha zero.

Mimoza Ahmetaj - Propozoi që ndryshimi në amendament të jetë: “nga lindja deri në moshën 18 vjet”.

Gjylnaze Sylja - Propozoi që në amendamentin 4, në vend të fjalës “apo” të jetë fjala “dhe”. Ajo pyeti nëse është llogaritur kostoja e ligjit për propozimin që fëmijë me aftësi të përhershme fizike të kufizuara, mendore dhe shqisore të konsiderohen fëmijët prej “lindjes” deri në “moshën 18-vjeçare”. Ajo pyeti se a do të mund të zbatohet Ligji me këtë propozim.

Nurishahe Hulaj - Tha se mosha zero konsiderohet mosha nga lindja deri në njëzeteshtatë ditë.

Qamile Morina - Tha se do të ketë shumë përçarje. Për shembull fëmija që lind dhe e ka një cefalinë, një meningocelë, duhet të konsiderohet aftësi e kufizuar. Ky fëmijë trajtohet brenda vitit, prandaj nëse ai hynë në këtë kategori, shumë vështirë mund të hiqet prej të ardhurave që do t’i fitojë, madje ka anomali që nuk mund të korrigjohen brenda vitit. Ajo propozoi që t’i jepet hapësirë kohës prej një viti, që anomali të që janë të korrigjueshme të ndreqen. Nëse këto anomali nuk janë të korrigjueshme, atëherë këta fëmijë mund të përfshihen në këtë kategori. Mirëpo shumë kokëçarje do t’ua bëni prindërve fëmijët e të cilëve lindin me anomali. Ata të gjithë do të ngulin këmbë të përfshihen në këtë kategori. Ajo propozoi që kjo çështje të mos amendamentohet, por të mbetet si në Projektligj.

Komisioni u pajtua që amendamenti 4 të kalojë me ndryshimin që fëmijë me aftësi të përhershme fizike, mendore dhe shqisore të kufizuara, të konsiderohen fëmijët prej “lindjes deri në moshën 18-vjeçare”.

Amendamenti 11

Në nenin 10, paragrafi 1, pas pikës 5, shtohet një pikë e re 6, “ *specialist i psikiatrisë*”.

Gjylnaze Sylja - Me qëllim të harmonizimit të pikës 6, me pikat e tjera të nenit 10, propozoi që në vend të fjalëve “*specialist i psikiatrisë*” të jenë fjalët “*mjek specialist i psikiatrisë*”.

Komisioni e miratoi amendamentin 11, me propozimin e deputetes Gjylnaze Sylja.

Amendamenti 13

Në nenin 16, paragrafi 3, në rreshtin e parë, pas fjalës “*vlerësimin*” hiqen fjalët “*dhe kategorizimin*”.

Kryetari - Pyeti se nëse Komisioni për vlerësimin dhe kategorizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk e bën kategorizimin, atëherë kush e bën këtë kategorizim?

Flora Brovina - Tha se ky Ligj nuk e bën kategorizimin. Kategorizimi është diçka tjetër. Të gjitha ligjeve, që kanë kaluar në këtë Komision, u ka munguar kategorizimi.

Rita Hajzeraj - Tha se ekziston komisioni që e bën kategorizimin e fëmijëve.

Komisioni nuk e miratoi amendamentin 13

Rita Hajzeraj – E propozoi riformulimin e paragrafit 6 të nenit 23: “*Pala e pakënaqur me vendimin e shkallës II, ose kur i ndërpritet e drejta e beneficimit a e përkujdesjes në mënyrë të paligjshme, ka të drejtë t`i drejtohet gjykatës kompetente*”.

Komisioni nuk e miratoi propozimin e deputetes Rita Hajzeraj.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për propozimamendamentet e paraqitura nga deputetja raportuese Flora Brovina, lidhur me Projektligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara.

Kryetari konstatoi se unanimisht u miratuan amendamentet e propozuara.

Amendamenti 1

Në vend të Kuvendi i Kosovës te thuhet Kuvendi i Republikës së Kosovës

Komisioni funksional

Amendamenti 2

Preambula pjesa e par riformulohet :
Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të kreut 5.1 (j) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë

Komisioni Funksional

Amendamenti 3

Në nenin 1 në rreshtin e dytë pas fjalës “ të cilët ruajnë ” hiqet fjala “**dhe kujdesën**” zëvendësohet me fjalën “ **përkujdesen**”

Komisioni Funksional

Amendamenti 4

Në nenin 2 paragrafi 1 ne rreshtin e dytë fshihet “**apo** “ zëvendësohet me „ **dhe**” ndërsa në rreshtin e tretë fshihet ” 1 ” dhe bëhet “ **nga lindja deri në** ” dhe vazhdon teksti si në P/Ligj .

Komisioni Funksional

Amendamenti 5

Në nenin 2 paragrafin 3 dhe 4 fshihet fjalia "ndihmës për kujdes te huaj" zëvendësohet me fjalën „përkujdesje“

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 6

Në nenin 2 paragrafi 5 riformulohet:

(5) “Përkrahje materiale” është benificion në formë të shumës financiare mujore ose formë tjetër e shpërblimit në të holla që administrohet nga MPMS-ja , për familje me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 7

Në nenin 2 paragrafi 12 në rreshtin e dytë pas fjalës shkallës “ fshihet fjala “ dhe peshës” dhe ne rreshtin e tretë pas fjalës “shqisor” shtohet fjala “ te kombinuar”

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 8

Në nenin 2 paragrafi 14 ne vend të fjalës “çdo qenie njerëzore” të thuhet “çdo person “

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 9

Titulli i kapitullit III riformulohet :

“Komisioni vlerësues për përcaktimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme”

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 10

Në nenin 10 paragrafi 1 pas pikës 5 shtohet pik e re 6 « Mjek specialist i psikiatrisë “

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 11

Në nenin 12 paragrafi 2 fjala "pacientin" zëvendësohet me fjalën "personin"

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 12

Në nenin 18 paragrafi 3 fshihet .

Komisioni Funksional

Amendamenti 13

Në nenin 21 paragrafin 1 ne pikën 2 pas fjalës letërnjoftimit “ fshihet fjala "nëse ka".

Komisioni Funksional

Amendamenti 14

Në nenin 21 paragrafi 1 te shtohet pika 6 me përmbajtjen :

„Informatat e vendbanimit të fëmijës me aftësi të kufizuara “ .

Komisioni Funksional

5. Të ndryshme

Gjylnaze Sylja - Tha se në raportin përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës, në diskutimin e saj, që është përfshirë në këtë raport, të shtohet edhe propozimi i saj, të mos bëhet asnjë ndryshim–plotësim në Ligjin për Inspektoratin e Punës, pa kaluar Ligji bazik i punës.

Flora Brovina - Tha se edhe në mandatin e kaluar, Komisioni i ka ndalur të gjitha ligjet që kanë pasur lidhshmëri me Ligjin bazik të punës. Ajo i propozoi kryetarit të Komisionit që të përcillet mesazhi që sa më shpejtë Kosova ta ketë Ligjin bazik të punës.

Kryetari - Tha se e ka pranuar një kërkesë nga Federata Sindikale e Shëndetësisë e Kosovës (FSSHK) për takim. Ai tha se në mbledhjen e radhës Komisioni do të ketë takim me përfaqësuesit e FSSHK-së, me drejtorin e Qendrës Emergjente dhe me drejtorin e QKUK-së.

Rita Hajzeraj - Ishte e mendimit që në këtë takim të ftohet edhe ministri i Shëndetësisë.

Gjylnaze Sylja - Tha se është mirë që Komisioni paraprakisht të ketë njohuri rreth kërkesave të kësaj Sindikate.

Flora Brovina - Tha se nëse ftohen në takim përfaqësuesit e kësaj Sindikate, atëherë duhet të ftohen edhe përfaqësuesit e sindikatave të tjera.

Armend Zemaj - Tha se është mirë të ftohet drejtori i QKUK-së, pastaj vlerësoi se cilat nga departamentet duhet të jetë i pranishëm në këtë takim.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 13:00

Mbledhja e radhës do të mbahet të martën e ardhshme më 22. 04. 2008

Përgatitur nga

Zyra e Komisioneve të Kuvendit

*Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz*